



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

Nr. 16573 Prot.

Lezhë, më 25.08. 2026

PROJEKT-VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIM “Nr. 104, Datë 26.11.2025”
PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE PËR
SHËRBIMET PUBLIKE DHE ATO ADMINISTRATIVE, LEHTËSIRAT
FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES
SË PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE**

Në mbështetje të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar (Neni 9, pika 1.1/b; Neni 54, shkronja "f" dhe Neni 55, pika 2) ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, si dhe bazuar në nevojën për përmirësimin e shërbimit në kopshtet publike, propozohet përcaktimi i tarifës së pagesës mujore për fëmijët që frekuentojnë kopshtet publike në administrim të Bashkisë Lezhë. Kryetari i Bashkisë Lezhë:

PROPOZON

- 1- Niveli i tarifës bëhet 220 lekë/ditë
- 2- Frekuentimi i kopshtit të kushtëzohet me shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, sipas legjislacionit dhe rregullave në fuqi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

KRYETARI
Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

Nr. 16573/Prot.

Lezhë, më 25.08. 2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E PËRCAKTIMIT TË TARIFËS SË KOPSHTEVE PUBLIKE NË BASHKINË LEZHË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, propozohet miratimi i përcaktimit të tarifës mujore për frekuentimin e kopshteve publike në administrim të Bashkisë Lezhë.

Ky përcaktim vjen si nevojë për përafrimin e kostos së ushqimit me koston reale të shërbimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas të cilit tarifa e ushqimit duhet të pasqyrojë shpenzimet faktike të realizuara. Tarifa e ofrimit të ushqimit në kopshte nuk është ndryshuar në Paketat Fiskale të miratuara vitet e fundit, gjë e cila ka bërë që të mos pasqyrohet kostoja e rritur e ushqimeve sipas vlerës së tregut me koston e faturuar realisht çdo muaj kundrejt shërbimit të ushqimit të ofruar në kopshte.

Rritja e kërkesës për akomodim të fëmijëve me ushqim në kopshtet e qytetit, ka bërë që gjithashtu të rriten kostot e ofrimit të këtij shërbimi, duke detyruar Bashkinë të planifikojë shpenzime të rritura për ofrimin e këtij shërbimi për qytetaret e saj. Aktualisht, në 5 kopshtet që ofrojnë shërbimin e ushqimit në Bashkinë e Lezhës numri i fëmijëve të akomoduar të cilët marrin këtë shërbim është 553 fëmijë. Në vitin akademik 2024 – 2025 ky numer ishte 545 ndërsa në vitin akademik 2023 – 2024 numri i fëmijëve ka qënë 476.

Gjithashtu duhet theksuar se 141 fëmijë janë të akomoduar pa shërbimin e drekës, si pasojë e mungesës së hapësirave të nevojshme për ofrimin e tij.

Për më tepër, nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për 3 vitet e fundit, rezulton se deri tani të ardhurat e mbledhura nga tarifa e ushqimit kanë qënë më të ulëta se kostoja reale e përballuar nga institucioni dhe se rritja e numrit të debitoreve e ka thelluar më tej këtë vlerë debitore.

Kontrata e ushqimeve për tre vitet e fundit ka qënë:

- 2024- 9.500.000 lekë
- 2025- 10.000.000 lekë
- 2026- 12.000.000 lekë (në tabelën me poshtë e perlllogaritur perperiudhen 6 mujore)

Nderkohe të ardhurat, shpenzimet dhe debitoret nga kopshtet për periudhën Janar 2024- Qershor 2026 janë si më poshtë:

Shpenzimet e Kopshtit 2024- Qershor 2026	2024	2025	2026 (6 mujori i Ire)	Totali 3 vitet e fundit
Kontrata e Ushqimeve	9,500,000	10,000,000	7,500,000	25,500,000
Te ardhurat nga kopshtet	9,799,479	9,254,488	6,979,398	26,033,365
Debitoret	961,778	958,350	621,899	2,542,027
Totali	(662,299)	(1,703,862)	1,142,501	(3,508,662)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

Për te gjitha arsyet e lartpermendura, propozohet marrja e këtyre masave:

- * Rishikimi dhe rritja e tarifës ditore të ushqimit, në mënyrë që ajo të përputhet me koston reale të shërbimit.
- * Marrja e masave për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura (debitoret) nga prindërit që nuk kanë shlyer tarifat në kohë.
- * Zbatimi i rregullit që frekuentimi i kopshtit të kushtëzohet me shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, sipas legjislacionit dhe rregullave në fuqi.
- * Tarifa e ushqimit do të llogaritet për çdo ditë kur ushqimi është përgatitur për fëmijën. Në rastet kur prindi njofton paraprakisht mungesën e fëmijës, sipas afateve të përcaktuara nga kopshti, tarifa për ditët e njoftuara nuk do të ngarkohet. Në të kundërt, kur mungesa nuk njoftohet paraprakisht dhe ushqimi është përgatitur, tarifa përkatëse do të paguhet nga prindi, pasi shpenzimi është kryer nga institucioni.

Bazuar në koston e përlllogaritur të menusë së ushqimit në kopshte të miratuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve pagesa e re do të bëhet 220 lekë/ditë per femije.

Referuar Ligjit nr.139,2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, prindërit do të paguajnë vetëm koston e ushqimit për fëmijët që frekuentojnë kopshtet publike. Te gjitha shërbimet e tjera mbështetëse ofrohen pa pagesë nga Bashkia Lezhë.

Ndër shërbimet dhe shpenzimet e përballuara nga Bashkia përfshihen si mëposhtë, referuar kostove të evidentuar në VKB, buxhetin e Dr. Arsimit për 3 vitet e fundit.

Këto kosto ndryshojnë në varësi të buxhetit të 3 viteve të fundit.

➤ **2024 – 10.896.800 lekë**

- * Materiale ndërtimore – 2.800.000 lekë
- * Materiale hidraulike – 568.750 lekë
- * Materiale elektrike – 596.750 lekë
- * Detergjentë – 2.500.000 lekë
- * Mobilimi i kopshteve – 600.000 lekë
- * Blerje elektroshtëpiake – 1.000.000 lekë
- * Mirëmbajtja e elektroshtëpiakeve – 1.200.000 lekë
- * Mjetet didaktike – 500.000 lekë
- * Materiale të buta – 500.000 lekë
- * Pompa uji – 600.000 lekë
- * Analizë e ujit të pijshëm – 31.300 lekë

➤ **2025 – 12.861.300 lekë**

- * Materiale ndërtimore – 4.025.000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

- * Materiale hidraulike – 980.000 lekë
- * Materiale elektrike – 1.225.000 lekë
- * Detergjentë – 2.500.000 lekë
- * Blerje elektroshtëpiake – 700.000 lekë
- * Mirëmbajtja e elektroshtëpiakeve – 200.000 lekë
- * Mjetet didaktike – 1.000.000 lekë
- * Materiale të buta – 1.000.000 lekë
- * Blerje moketi – 600.000 lekë
- * Pompa uji – 100.000 lekë
- * Analizë e ujit të pijshëm – 31.300 lekë
- * Enë kuzhine – 500.000 lekë

➤ **2026 – 52.769.311 lekë**

- * Materiale ndërtimore – 5.475.000 lekë
- * Materiale hidraulike – 980.000 lekë
- * Materiale elektrike – 1.225.000 lekë
- * Detergjentë – 1.021.731 lekë
- * Blerje elektroshtëpiake – 500.000 lekë
- * Blerje kondicionerësh - 1.540.000 lekë
- * Mirëmbajtja e elektroshtëpiakeve – 200.000 lekë
- * Mjetet didaktike – 500.000 lekë
- * Materiale të buta – 500.000 lekë
- * Blerje moketi – 843.000 lekë
- * Pompa uji – 100.000 lekë
- * Analizë e ujit të pijshëm – 31.300 lekë
- * Mirëmbajtje ashensori - 120.000 lekë
- * Materiale mobilimi – 1.000.000 lekë
- * Rikonstuksion total “11 Janari” & “Skënderbeg” – 38.733.280 lekë

Fëmijët që frekuentojnë kopshtet publike përfitojnë pa pagesë:

- * Shërbimin edukativ dhe pedagogjik;
- * Fjetja (krevatë, çërçafë, lavanderi)
- * Veprimtari social-kulturore dhe argëtuese;
- * Aktivitetet sportive dhe zhvilluese;
- * Kujdesin dhe mbikëqyrjen gjatë orarit zyrtar;
- * Ambjente të përshtatshme dhe të mirëmbajtura;
- * Materiale bazë didaktike dhe edukative sipas programit të institucionit.
- * Rikonstruksimin e të gjithave ambjente ekzistuese
- * Dezinfektimin e të gjithave ambjente ekzistuese
- * Ndërtimin e kopshteve të reja për të përballuar kërkesat në rritje.

Për të garantuar mbarëvajtjen administrative dhe funksionimin normal të kopshteve, do të ndryshohen gjithashtu vendosja e disa rregullave për frekuentimin dhe pagesat, konkretisht:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

- * Në rast se prindi rezulton debitor për më shumë se 2 muaj, fëmija nuk do të pranohet në kopsht deri në likuidimin e plotë të detyrimit.
- * Në rast se fëmija mungon për më shumë se 1 muaj pa njoftim paraprak ose pa raport mjekësor përkatës, ai çregjistrohet nga kopshti.
- * Në rast mungese pa njoftim të paktën 1 ditë përpara, dita e munguar do të konsiderohet e konsumuar dhe nuk do të zbritet nga tarifa mujore.
- * Orari i funksionimit të kopshteve publike do të jetë nga ora 07:00 deri në orën 16:30.
- * Kopshtet do të funksionojnë gjatë gjithë vitit kalendarik, me përjashtim të një periudhe prej 2 javësh gjatë sezonit veror për rikonstruksion, mirëmbajtje dhe dezinfektim të ambienteve.

Ky propozim synon:

- * Rritjen e cilësisë së shërbimit për fëmijët;
- * Përmirësimin e administrimit financiar dhe organizativ të kopshteve;
- * Garantimin e një sistemi më të rregullt dhe funksional për frekuentimin e institucioneve parashkollore;
- * Mbështetjen e familjeve përmes ofrimit të shërbimeve edukative falas dhe pagesës vetëm për ushqimin.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i këtij projekt-vendimi nga Këshilli Bashkiak Lezhë.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

Nr. 16573/2 Prot.

Lezhë, më 25.08 2026

PËR

MIRATIMIN E NIVELIT TË TARIFËS PËR SHËRBIMIN AKOMODIMIT DHE OFRIMIT TË USHQIMIT NDAJ FËMIJËVE NË KOPËSHT

B.10. Tarifa për shërbimin akomodimit dhe ofrimit të ushqimit ndaj fëmijëve, në

Kopësht.

B.10.1. Përkufizimi

Në shërbimin e akomodimit dhe ofrimit të ushqimit ndaj fëmijëve, futen të gjithë ato që regjistrojnë fëmijët në Kopshte.

B.10.2. Niveli i Tarifës

Niveli i tarifës **ishte** sipas kategorive si më poshtë:

Nr	Kategoria e shërbimeve	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Akomodim në Kopësht	Lekë/ muaj	E barabartë me koston e shërbimit

Niveli i tarifës **bëhet** sipas kategorive si më poshtë:

Nr	Kategoria e shërbimeve	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Akomodim në Kopësht	Lekë/ muaj	220 lekë/ ditë

B.10.3. Baza e tarifës

Ishte:

Për shërbimin e ofruar do jetë kosotoja në lekë/ditë qëndrimi për çdo fëmijë, kosto e cila përfshin vetëm shpenzimet për ushqimin e fëmijëve, i cili është regjistruar në atë Njësi Shërbimi.

Bëhet:

Për shërbimin e ofruar do jetë kosotoja në **220 lekë/ditë** qëndrimi për çdo fëmijë, kosto e cila përfshin vetëm shpenzimet për ushqimin e fëmijëve, i cili është regjistruar në atë Njësi Shërbimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

B.10.4. Strukturë përgjegjëse

Për llogaritjen e koston dhe përgatitjen e formatit të faturës për arkëtim të nivelit të “Tarifës për Ofrimin e Shërbimit të Qëndrimit në Kopësht”, janë Drejtoria Finances dhe Buxhetit/ Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Për vjeljen e tarifës, Drejtoria përkatëse sipas informacionit të marrë nga Institucioni i Kopshtit, së qytetit për numrin e fëmijëve të akomoduar gjatë muajit, harton faturën për arkëtim për çdo kryefamiljar.

B.10.5. Afati i pagesës

Ishte:

Për kryerjen e pagesës për regjistrimin në Kopësht, kryefamiljarët janë të detyruar të bëjnë një pagesë paradhënie, në vlerën e shpenzimeve mujore të një muaji më pare, por jo më pak se 2.500lekë. Më pas ato faturohen sipas koston mujore nga Drejtoritë përkatëse të sipërcituara, duke respektuar afatin jo më vonë se 10 ditë nga muaji pasardhës.

Bëhet:

Për kryerjen e pagesës për regjistrimin në Kopësht, kryefamiljarët janë të detyruar të bëjnë një pagesë paradhënie, në vlerën e shpenzimeve mujore 4840 lekë. Më pas ato faturohen sipas koston mujore nga Drejtoritë përkatëse të sipërcituara, duke respektuar afatin jo më vonë se 10 ditë nga muaji pasardhës. Pagesa e pare paradhënie do të konsiderohet si pagesë e muajit të fundit.

B.10.6. Lehësitrat fiskale

Do përfitojnë një zbritje në masë 50% të tarifës nga pagesa për Tarifën e shërbimit të akomodimit dhe ushqimit ndaj fëmijëve, në Njësitë e Shërbimit në Kopshte, kategoritë e mëposhtme:

- Familjet, që kanë krye-familjarin invalid,
- Familjet, që kanë në përbërjen e tyre, të verbër, të sëmurë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
- Familjet, që janë përfituese të ndihmës ekonomike.
- Familjet e komunitetit Rom.

KRYETARI
Pjerin NDREU

